



Npi – 01/136 datë: 17.06.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e tretë të Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 17.06.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -III- të Jashtëzakonshme për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, e mbajtur më datën 17.06.2026 (e mërkurë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e jashtëzakonshme e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Rrahman Jakupi. Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, znj.Albana Ramadani, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi dhe z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari, z.Adnan Ademi; DPUKGJ, z.Bardhyl Rushiti; DSHP, z.Halil Kurtishi; DZHE, z.Grejtalb Emini; DBF, z.Besnik Ahmeti. Zyrtare, znj.Vlora Hyseni; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi; Praktikantët, z.Albion Shabani, znj.Hava Llugaxhija, znj.Admire Selmani dhe znj.Teuta Mustafa, znj.Valmira Behluli. Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi e njoftoi Kuvendin me rendin e ditës të propozuar si vijon:

REND DITE

1. Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2025 në vitin 2026.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Para se të vazhdoj mbledhjen, e konstatoj kuorumin me 20 anëtarë të Kuvendit. Është vetëm një pikë e rendit të ditës, mbledhje kjo e propozuar nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit. Po e hedh në votim rendin e ditës ashtu siç ka ardhur nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika I

Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2025 në vitin 2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hap debatin për këtë pikë. Fjalën ia jep z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Më lejoni që përmes kësaj seance të jashtëzakonshme, duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, ne e dimë që të gjitha ndarjet buxhetore përfundojnë në mesnatën e 31 dhjetorit të vitit aktual, përveç të hyrave dhe të barturave që barten në vitin vijues. Ne, si Drejtori e Financave, së bashku me ekzekutivin, i kemi sjellë propozimet tona për të hyrat e bartura në vlerë 195,572.38 euro. Të hyrat janë të parapara në këto programe dhe nënprograme. Në vazhdim lexoi materialin si në vijim (*shih dokumentin*).

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Në lidhje me këtë pikë të veçantë, ne si grup i Asamblesë Komunale e kemi ftuar këtë seancë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj pike, të cilën na obligon edhe Ligji për Financat Publike. Bazuar në të

gjitha sqarimet e DBF-së, më intereso i edhe çështja e katastrofave natyrore, meqenëse janë dy kolona të parapara, njëra ishte në vlerë 19,000 euro dhe tjetra në 34,500 euro. Është mirë të jepet një sqarim më i detajuar. Sa i përket gjithë këtyre të barturave, ne si grup i Asamblesë Komunale do të jemi për, ashtu siç është propozuar.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Për bartjen e këtyre mjeteve, kisha dashur shumë që të ishte e specifikuar çështja e katastrofave natyrore, kur dihen dëmet që janë bërë nga reshjet atmosferike dhe nuk është marrë asnjëherë vendim për t'u bërë ndonjë pagesë. A do të bëhet ndonjë pagesë me këto mjete që jemi duke i bartur? Ne jemi në parim për ta votuar këtë pikë, por me kushtin që ju të vini dhe të dëshmoni me fatura se ku janë duke shkuar këto mjete, e jo ne vetëm të votojmë dhe të mos dimë se ku janë duke shkuar këto mjete.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Kur flasim për qëndrimet dhe parimet e LDK-së në lidhje me të gjitha këto çështje buxhetore, ne e kemi thënë qëndrimin tonë që në seancën e parë. LDK-ja gjithmonë është këtu për të përkrahur, por gjithmonë me rekomandimet dhe sugjerimet tona, jo për ta paraqitur ekzekutivin keq, por për hir të qytetarëve. Unë dua të bëj një sqarim për hir të qytetarëve. Së bashku me Nënkrjetarin kemi shkuar për të biseduar miqësisht me Drejtorin e DBF-së. Ne si LDK kemi kërkuar që një pjesë, sado e vogël, të bartet për arsim dhe specifikisht për Drejtorinë e Arsimit. Drejtori e ka paraqitur dokumentin që Drejtorët e shkollave kanë buxhet, por nuk po e shfrytëzojnë. Nga kjo foltore ju bëj thirrje drejtorëve të shkollave që buxhetin t'a përdorin, sepse e dimë që në secilën shkollë ka mungesë të printerëve dhe tonerëve. Është pak më e vështirë, sidomos po flas për ciklin e ulët. Tek pjesa tjetër, ne si LDK kemi kërkuar transparencë, mirëmenaxhim dhe shpërndarje të drejtë. Ju e keni paraqitur formën tabelare në këtë bartje, por pa sqarime të detajuara, të përsëritura dhe pa adresë. Pa sqarime i bie jo bindëse, të përsëritura i kemi dy kolona me të njëjtin emërtim, por me vlera të ndryshme dhe pa adresë. Nuk ka specifikim të saktë se ku saktësisht do të shkojnë këto investime. Qytetarët duhet të dinë pse po bëhet kjo bartje, cilat projekte po dëmtohen dhe po preken. Nuk është e natyrshme të dalim në fusha apo debate publike dhe të premtojmë shumë projekte, e në fund t'i ngremë duart e të themi se na i mori përmbaruesi. Kontratat kolektive nuk kanë lindur sot. Te specifikimi është pjesa tjetër që shënon ndërtimin e rrugëve, segmenteve rrugore, ndriçimit dhe kanalizimit. A i kemi harruar emrat e këtyre rrugëve dhe fshatrave? Ku, në Rashincë, Muzeqinë, Gllavicë apo diku tjetër? Kemi kërkuar dhe gjithmonë po kërkojmë specifikim, sepse ne në fund të fundit i dimë, por këtu jemi të përfaqësuar për qytetarin dhe jemi të interesuar ta informojmë qytetarin për të gjitha këto veprime.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. E përkrah bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026, ashtu siç janë planifikuar. I përkrah po ashtu edhe mini-ndryshimet që kanë ndodhur.

z.Atdhe Isufi: Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin lidhur me kodin 55132, rregullimi i rrugëve dhe trotuareve: trotuari në rrugën "Ulqini", segmenti i rrugës "Jashari" dhe vazhdimi i trotuarit në Muzeqinë. Me sa di unë, trotuari për Muzeqinë është i përfunduar. Trotuari në rrugën "Ulqini" nuk ekziston. Sa i përket segmentit të rrugës "Jashari", nëse e quajmë segment atë pjesë ku i është shtuar rreth një metër asfalt për së gjati, atëherë segment unë e di që është komplet një pjesë e rrugës. Me këtë pagesë, a përfundon trotuari në rrugën "Ulqini"? Ku do të shtrohet segmenti i rrugës "Jashari" apo është kjo vetëm shtesa me një metër anash? Te planifikimi urban, kodi 66066304 në vlerë prej 30 mijë eurosh, a ka specifikim për çfarë po ndahen këto mjete? Po ashtu, te menaxhimi i katastrofave natyrore 34,845.00 euro, për çfarë janë destinuar këto mjete?

z.Faik Ramadani: Përshëndetje. Edhe unë i kam shqetësimet e mia sa i përket specifikimeve. Pse në katër vende figuron rruga "Idriz Ajeti", ndërsa kërkesat konkrete që i kemi nuk janë këtu? Më informoni dikush çfarë paraqet, nga pika në pikë, rruga "Idriz Ajeti"? Edhe pse shumica e këtyre punëve janë të kryera, nuk kam shpjegim për këto. Shqetësimet e mia lidhen me KAB 2027-2029. Asnjë kërkesë e imja nuk është e përfshirë në KAB. Nëse nuk kemi mundësi t'i përfshijmë kërkesat e banorëve të Pjetërshticës, unë do të lloboj bashkë me kolegët e PDK-së, LDK-së dhe VV-së që të mos votojmë gjëra që nuk na hyjnë në punë. Për Pjetërshticën nuk jam i kënaqur. Nuk mund të qëndroj kot dhe të flas kot.

z.Shefqet Krasniqi: Dua ta bëj një pyetje, nëse më lejohet. Drejtor, kur do të filloni me i heq mbeturinat e fshatrave Dugë dhe Karaçicë, sepse pamja panoramike është shumë e rënduar nga ato mbeturina dhe krijojnë një pamje jo të mirë?

z.Haqif Arifi: Përshëndetje. Kjo bartje, e dimë që është e lejuar me ligj, por ligji nuk lejon përdorim pa kufi, pasi ekzistojnë kufizimet kontabël, të cilat orientojnë edhe destinimin e mjeteve. Kryesisht, në këtë bartje kërkohen obligimet për projektet e përfunduara, për projektet e papërfunduara dhe për kontratat e nënshkuara, ndërsa nuk pashë që janë të destinuara për ndonjë projekt të ri. Shihet edhe ndarja e 78.000 eurove për shpenzime komunale, që për mua është një shumë e paarsyeshme dhe do të ishte më mirë të investohej në shërbime kapitale. Më e mira do të ishte që mjetet të destinoheshin për projekte të reja që prekin qytetarin dhe jo për mallra dhe shërbime. Nga cilat projekte janë bartur këto mjete dhe cilat mendoni se janë dëmtuar më së shumti nga investimet kapitale? Në dokument kemi projekte me bashkëfinancim dhe te projektet me bashkëfinancim përmenden edhe obligimet. A ka ekzistuar ndonjë marrëveshje mes këtyre organizatave dhe ministrive? A nuk kemi paguar ne si komunë, apo i kanë paguar institucionet, ministrinë apo organizatat që kanë qenë bashkëfinancuese? U përmend që ka marrë përmbaruesi, por e dimë që nuk është hera e parë. E dimë që komuna nuk e ka bërë nënshkrimin e kontratës kolektive, por komuna e ka obligim t'i kryejë ato obligime. Po të kishte qenë viti i parë ose i dytë, do të kishte pasur një arsyetim, por komuna është dashur të ketë një paraplanifikim që të mos mbetet gjithmonë arsyetimi te përmbaruesi.

znj.Arbresha Sylja: Përshëndetje. Është propozuar kjo bartje për ndërtimin e urave në Shtime, Godanc dhe Pjetërshticë. Po flas të paktën për Godancin: për cilat ura e keni fjalën më konkretisht? E dëgjova me vëmendje pyetjen e kolegut lidhur me projektet për të cilat mjetet i ka marrë përmbaruesi. Ne duam të kemi informacion se si janë pranuar ato projekte. Kërkojmë më shumë sqarime për këto projekte. Të dalin mjetet dy herë për një projekt, konsideroj se është shkelje në vetvete.

znj.Albana Podvorica - Hoxha: Përshëndetje. Te kolona e parë, që është për planifikimin urban dhe inspektimin, duke e ditur që rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në rrugën “Ulqini” dhe segmenti në rrugën “Jashari” janë planifikuar edhe në vitin 2024 dhe vazhdojnë në vitet 2025 dhe 2026, ajo që më intereson të di është sa mjete i ka marrë përmbaruesi dhe ku keni menduar t'i siguron mjetet e tjera për të vazhduar këto projekte? Pasi ato kanë qenë të planifikuara nga viti 2024 deri në vitin 2026.

z.Shefqet Krasniqi: Po kalojmë te kolona tjetër, menaxhimi i katastrofave natyrore. Keni bërë një ndërlidhje të mallrave dhe shërbimeve te kjo kolonë. Me sa mbaj mend, komuna me buxhetin vetanak ka bërë pagesa për vërshime ose katastrofa. A ka bërë ndonjëherë komuna pagesa të tilla, apo vetëm niveli qendror? Pikërisht për këtë arsye po pyes pse po futen këtu dhe pse po ndahen në dy pjesë.

znj.Fatlinda Rrafshi: Përshëndetje. I keni ndarë 5.000 euro për çerdhen. A është e vërtetë që këto mjete do të shkojnë për shpenzime komunale apo do të përdoren për pagesën e ushqimit? Pas takimeve me shumë prindër, fëmijët po ankohen se nuk ka larmi në ushqime dhe kjo po ndodh pasi është ndërprerë ndërhyrja e prindërve në institucion.

z.Haqif Arifi: Cilat drejtori kanë më së shumti obligime të papaguara?

z.Bajram Hajrizi: Përshëndetje. Te arsimi fillor, për ndërtimin e sallave në fshatrat Zborc dhe Reçak, a ju mjaftojnë këto mjete që nxënësit ta nisin vitin shkollor me salla të reja dhe ta mbajnë orën e parë të edukatës fizike në to?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket pyetjes për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, mund të ketë dy linja, por mund të ketë edhe pesë, për shkak se janë pesë kategori ekonomike: pagat, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe subvencionet. Sa i përket dëmeve, komuna nuk i mbulon ato, pasi i takojnë nivelit qendror. Të gjitha propozimet që kanë ardhur nga DBF-ja nuk kanë mundësi që, pasi të aprovohen në Kuvend, t'u ndryshohet kategoria ekonomike, sepse ka shumë filtra deri te alokimi i tyre. Përveç kësaj, duhet të arsyetohet secili shpenzim në Ministrinë e Financave, proces i cili kërkon korrespondencë dhe dokumentacion shtesë. Unë nuk jam këtu për të arsyetuar të hyrat dhe bartjet, por çdo shpenzim. Çdo asambleist

që ka nevojë për sqarime se ku kanë shkuar mjetet, sa janë paguar dhe kujt janë paguar, mund të marrë informacionet e nevojshme. Përmbaruesi nuk po na lejon të fillojmë projekte të reja, ndërsa projektet ekzistuese janë obligime kontraktuale. Drejtoria e Arsimit pjesën më të madhe të shpenzimeve e ka në tremujorin e tretë dhe ka buxhet të mjaftueshëm. Ne kemi mundësinë të bëjmë lëvizje të mjeteve nëse ndonjë drejtori ka obligime. Sa i përket projektit 55132, gjatë planifikimit të buxhetit sistemi PIPA nuk lejon përshkrime të gjata dhe duhet të përdoret një emërtim më i përgjithshëm. Projekti ka qenë dy vjeçar dhe nga shuma prej 11.000 eurosh, një pjesë është ekzekutuar nga përmbaruesi. Këto janë mjete që duhet t'i rikthejmë si obligim. Sa i përket rrugës "Adem Jashari", bëhet fjalë për obligim kontraktual. Nuk e di nëse puna ka përfunduar në terren, por ne kemi nënshkruar kontratën dhe, nëse punët nuk kryhen, pagesa nuk realizohet. Ju ftoj në zyrë që t'i shikojmë projektet bashkë. Sa i përket projektit prej 30.000 eurosh në DPUKGJ, gjatë vitit 2025 hartimi i projekteve ideore për investimet kapitale është realizuar nga kjo drejtori. Kjo shumë bazohet në kontratë të nënshkruar dhe është obligim i komunës që të përmbushet. Nëse nuk mbyllet kontrata, pasojat mund të jenë edhe më të mëdha për shkak të procedurave përmbarimore. Për KAB-in kemi afat deri më 30 shtator dhe do ta sqarojmë bashkërisht duke e shqyrtuar qarkoren në detaje. Shpenzimet komunale janë shpenzime operative dhe pa to nuk mund të funksionojmë. Pa energji elektrike, ujë, mbeturina dhe shërbime telefonike nuk mund të ofrojmë shërbime. Për këtë arsye kemi propozuar mjete shtesë për QKMF-në dhe për çerdhen. Kur këto mjete specifikohen si shpenzime komunale, nuk mund të ndryshohet kategoria ekonomike, pasi sistemi nuk e lejon. Sa i përket projektit 53557, asnjë ekonomist nuk guxon të ndryshojë kategorinë ekonomike, sepse kjo përbën shkelje serioze ligjore. Te projektet me bashkëfinancim nuk do të thotë që komuna nuk ka paguar ose që ka paguar vetëm ministria e linjës. Komuna është pjesëmarrëse në financimin e projektit. Për shembull, te ndërtimi i objektit të ri të komunës, pjesa që i takon komunës mund të paguhet pas pranimit teknik, madje edhe me këste, varësisht nga kontrata. Një pjesë e këtyre mjeteve është marrë nga përmbaruesi për shkak të obligimeve ekzistuese. Sa i përket kontratës kolektive, nuk mund të planifikohen mjetet e pagave dhe të transferohen në mallra dhe shërbime. Pikërisht për këtë arsye nuk mund të ekzekutohet kontrata kolektive nga këto kategori buxhetore. Aktualisht, në DBF nuk kemi obligime të tjera përveç këtyre që lidhen me të hyrat dhe bartjet e mjeteve të ekzekutuara nga përmbaruesi. Sa i përket urave, kjo shumë është ekzekutuar nga përmbaruesi, ndërsa urat janë duke u ndërtuar në fshatin Pjetërshticë.

znj. Albana Podvorica: Te kolona e parë që ka të bëjë me planifikimin urban dhe inspeksionin, nëse e ka marrë përmbaruesi, është shumë e rëndësishme që të jetë në kolonën e parë. Kjo është planifikuar për vitin 2024, dhe ju lutem, më jepni mundësinë të merren parasysh shumat që duhet të vazhdojnë për të përfunduar ato plane të bëra në vitin 2024.

z. Besnik Ahmeti, DBF: Këtë shumë e ka ekzekutuar përmbaruesi. Në momentin që shtypet fatura brenda datës së kontratës, ajo lejohet të ekzekutohet edhe pasi kontrata skadon. Krejt kjo shumë ka qenë brenda vlerës së kontratës, shumë fikse, por këtë shumë fikse e ka marrë përmbaruesi. Në momentin që bëhet alokimi i kësaj shume, ekzekutohet për atë projekt.

z. Atdhe Isufi: Te 55132 nuk po besoj që ka projekt që përsëritet dhe vjen deri këtu. Për çdo metër ku ka mbetur, sa është obligimi dhe sa paguhet, sepse qytetarët duan përgjigje prej jush. Qenka drejtori i Urbanizmit këtu dhe e di saktë, nëse kryhet kjo bartje, a shtrohet trotuari në rrugën e Ulqinit dhe a do të kryhet ndonjë segment shtesë në rrugën Adem Jashari?

z. Shefqet Krasniqi: Kam një lutje. Po besoj që drejtori krejt këtë përgaditje të buxhetit e bën nga raportet e të gjithë drejtorëve të komunës dhe planifikimet e tyre. Do të donim që specifikisht të na përgjigjet drejtoria përkatëse. Po besoj që një drejtor që e ka nënshkruar një kontratë e di saktësisht datën e fillimit dhe të mbarimit. Andaj, lejoni që pyetjeve specifike t'u përgjigjet drejtori i drejtorisë përkatëse. Z. Halil Kurtishi më mbeti borxh për pyetjen që ua bëra.

z. Halil Kurtishi, DSHP: Përsëendetje. Ne e dimë që deponitë ilegale, qoftë në nivelin nacional apo lokal, janë sfidë, mirëpo, për të qenë më i shkurtër, po ju njoftoj që ne si drejtori, bashkë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kemi arritur një koordinim mes vete. Kemi bërë identifikimin e të gjitha deponive ilegale në Komunën e Shtimes. Më të mëdhatë

konsiderohen të jenë mbi 30, ndërsa të vogla ka edhe më shumë. Ne po përpiqemi çdo ditë dhe besoj që po e shihni edhe ndryshimin në qytetin e Shtimes që ka ndodhur, por është e pamundur që ne si drejtori, pa pasur një bashkëpunim si me ju ashtu edhe me qytetarët, ta arrijmë që qyteti të jetë në formën dhe mënyrën më të mirë. I nderuar, po besoj që brenda muajit ose javës do të ketë reagim, qoftë për fshatrat që i përmendët ju, qoftë për deponitë tjera.

z.Bardhyl Rushiti, DPUKGJ: Përsëritet. Kontrata kur është bërë, ne shkojmë sipas dëgjimeve publike. Kur t'i marrim kërkesat e qytetarëve, aty është përmendur, p.sh., trotuari në rrugën e "Ulqinit", por kur bëhen specifikat, nëse i ke 50 mijë euro dhe nuk mund ta arrish sasinë me ato para që i ke, atëherë duhet me e zvogëlu. Si emërtim mbetet aty. Domethënë, nuk ka pasur sasi të mjeteve për ta përfunduar atë trotuar. Sa i përket segmenteve, ka sa të duash rrugë që janë të shtuara në këtë kontratë. Ua përcjell edhe me email më saktësisht, sepse kemi shumë rrugë të shtuara.

z.Haqif Arifi: Dua t'ia bëj një pyetje Nënkrjetarit. Obligimet nga kontrata kolektive, a i merrni si obligime? Nëse po, çka keni bërë për to? Nëse jo, atëherë na merren mjetet nga përmbaruesi.

z.Atdhe Isufi: Përgjigjen me sa e kuptova unë është që rruga "Ulqini" nuk ka trotuar mos të presin. Te menaxhimi i katastrofave natyrore janë dy ura në Vojnoc. A kan mundur me u bë me gjysmën e këtyre mjeteve këto dy ura, më tregoni cila preventiv u marr prej se u vërshu asnjë 0. Është duke u punuar në lumë po jo zgjerimi ku janë ngushticat. Janë dy ura që janë në nivelin ku duhet me u kon dhe pse nuk është ndërmarrë asgjë.

z.Demokrat Mujota: Te kategoria e subvencioneve dhe transfereneve e kemi shumën 10.000 mijë euro a mund të n'a shpjegoni çka më saktësisht ka me u subvencionu?

z.Asllan Beqaj: Kjo qeverisje njihet për transparencë. Dua të ndërlidhem te bartja e të hyrave. Sa të ketë kontratë kolektive kemi me i pas këto probleme. Sa mjete monetare na i tërhek çdo vit përmbaruesi? Te emërtimet e mjeteve brenda një kornize ka qenë 5 projekte dhe përmbaruesi me ia blloku të hyrat për një projekt të caktuar.

z.Shefqet Krasniqi: Për të njëjtin projekt më shumë se 3-4 vite radhazi është thënë që janë marrë nga përmbaruesi, mirëpo mbetet këtu me pa dhe me vërtetu. Përmbaruesi kur të vjen, a mundemi të dirigjohet nga komuna në atë kuptimin me "e lut" dhe me i than mos na i merr këto pare këtu se jemi shumë keq.

Nënkrjetar, Adnan Ademi: Përsëritet. Fillimisht dua t'i falenderoj qytetarët për zgjedhjet nacionale që ka qenë dalja e qytetarëve në mënyrën më të mirë dhe më të qytetëruar. U bë pyetja a kemi obligime për kontratën. Unë po të them që komuna e Shtimes që nga viti 2022 i bën pagesat e kontratës kolektive por fatkeqësisht i bën përmes përmbaruesit. Po ndërlidhem me pyetjen që a të pyet përmbaruesi ku me i marr parat. Paraprakisht e ka dërgu një email 24 ose 48 orë që ti duhesh me dite që kjo shumë duhet të plotësohet ku po don me i marr parat në cilat projekte. Kontrata kolektive, realisht pajtohem me juve që e ka shkatërru buxhetin po ky vendim është marrë prej dikujt, ka adresë nuk po du me fol politikisht. Me një kohë ka qenë e mirë, kurse tash po del që nuk është e mirë. Ka komunë që ka filluar me i bë pagesat me kohë, ne si komunë kemi filluar në vitin 2022. Ka borxhe edhe të kontratave që kanë kry punë në kohë të fushatave, ka borxhe të kontratave që nuk janë shpronësuar në mënyrën e duhur dhe të kanë paditë dhe këto mbledhen. Te fshati Vojnovc, rruga "Jashari" është zgjeru për 1 metër është e vërtetë. Janë degëzimet e rrugës "Jashari". Vojnovci është 60% më mirë se sa që ka qenë duke i perfshi punët e mira që janë bërë. Shumë shpejt fillon ndërtimi i shkollës në fshatin Vojnoc. Ju lus me i pas parasysh të mirat që janë ardhë në komunën e Shtimes. Vend për përmisime ka për këtë punë.

z.Atdhe Isufi: Vojnovci e ka dhenë votën për ndryshim sepse ka qenë i harruar. E dyta, a i përmendi ish-drejtori i Urbanizimit disa rrugë me emra? Rrugët kur mirren me u shtriu, a i shtroni me rend apo kujt të doni? Qysh në bazë të kërkesave, një kojshisë me i'a shtriu rrugën deri para derës së shtëpisë e tjetrit me i'a hek zallin e vet e sot e asaj dite me mbet ashtu? Kështu nuk votohet, vetëm të jemi të qartë.

z.Shefqet Krasniqi: Këtu jemi edhe për të bërë politikë sepse në këto kollluke kemi ardh përmes politikës. Më shumë se 10 herë është thënë në këtë kuvend se jo përmbaruesi nuk të pyet ku me i marrë parat. Përmbaruesi bashkëpunon me komunën dhe nuk i zgjedh paratë a janë 500 euro, a

janë 1000 euro, a janë të infrastrukturës ose a janë në një drejtori tjetër. Përmbaruesi merr mendime dhe komuna bashkë me drejtorin e DBF-së mund t'a orinetoj duke i thenë "mos na i merr këtu, po merri këtu". Dua t'i tregoj kolegut tim Muhamet Ademaj që nëse të kanë thënë 3-4 herë radhazi se te projekti yt n'a i ka marrë përmbaruesi, nuk të kanë njoftu drejt.

z.Demokrat Mujota: Dua të lidhem me diskutimin që patën Nënkryetari me kolegun. Dua t'ju bëj një pyetje. Rugët që i keni shtruar nëpër oborre gjatë fushatës 2025 në zgjedhjet lokale, nëse atyre qytetarëve i keni marrë nënshkrim për t'u bërë prona publike? Ato janë prona private, por nëse ata kërkojnë dëmshpërblim, a keni llogaritur sa borxhe do të ketë komuna më pas? Lani borxhet edhe obligimet e juaja.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Kam kërkesë për pauzë, shkojmë 5 minuta në pauzë në ora 11:39. Vazhdojmë me mbledhjen në ora 11:57. Fjalën ia jap z.Shefqet Krasniqi.

z.Shefqet Krasniqi: Para se të vij votimi, kam një pyetje për administratën. A na kapin në kamerat kur votojmë? Sepse para 2-3 ditësh është bërë një dëgjim me bizneset, dhe është thënë që opozita po na bllokoi. Dhe asnjëherë në këtë kuvend pozita, kur ka qenë çështja për buxhetin, nuk ka thënë se kemi bllokim, përkundrazi, fuqimisht kemi përkrahje.

znj.Erza Salija: Dua t'i bëj një pyetje drejtorit të DSHP-së. Meqë tashmë keni mjete të mjaftueshme, politika me Reçakun nuk bëni. A jeni në dijeni që kompleksi memorial i Reçakut ka tash e sa muaj që mirëmbahet nga njerëz vullnet mirë nga fshati Reçak, më saktësisht nga mërgata e fshatit Reçak përmes Shoqatës Reçaku? A keni menduar të merrni ndonjë veprim në këtë drejtim? A keni ndarë mjete për Shoqatën e Veteranëve, sepse përgjigjia nuk u dha më parë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Tek kategoria e subvencioneve shuma në vlerë 10,000 euro është shumë për obligim për Shoqatën "Jetimat e Ballkanit". Duhej të ndërtohen 10 shtëpi. Në vitin 2024 dhe 2025, dhe ne kemi pasur një shumë për t'u paguar dhe tani kjo shumë e fundit është 10,000 euro këtë vit. Kjo shumë mbyllë komplet obligimin për marrëveshjen me "Jetimat e Ballkanit". Kur bëjmë specifikat në PIPA, mundohemi t'i përfshijmë segmentet me një term për shkakë se programi nuk lejon të shkruhen shumë shkronja. Sa i përket kontratave kolektive, në vitin 2023 janë paguar 514,000 euro, në 2024 janë paguar 865,000 euro, në 2025 janë paguar 737,000 euro dhe tani në 2026 janë afër 400,000 euro. Për të paguar kontratën kolektive duhet të hyjë në kategorinë e pagave, por BDMS programi kthen qarkoren e dytë. Kur të vjen raporti i Auditorit, ai e përfshin pasurinë e shtuar mbi 500,000 euro si raport të kualifikuar, a ti në realitet e ke apo jo? Në të dy anët ke bërë shkelje të ligjit. Zgjedhje ka vetëm nëse e shkelim ligjin.

z.Shefqet Krasniqi: Po ua rikujtoj që Nënkryetari e ka theksuar se përmbaruesi nuk na pyet neve, por ai duhet të na pyet. Nëse i merr, po e lidhi me pjesën tatimore, nëse ia ke referuar për marrjen e TVSH-së dhe ta merr te tatimi në fitim, ti e fiton lëndën. Përmbaruesi bashkëpunon me secilën komunë ku mund t'i marrë paratë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Ndoshta bashkëpunon me thesarin, por s'ka shans të bashkëpunojë me komunën. Nuk janë duke na pyetur prej korrikut të 2025 për shkakë të lëndëve që janë në thesarin, dhe nëse na pyesin, unë asnjë projekt kapital nuk e kam parë ku është projekti, a është në Dugë, Karaqicë apo Pjetërshticë. Nuk e dërgoj për ekzekutim se më ndalon ligji, le ta marrë vetë. Nuk guxojmë me nis projekt të ri pasi kemi obligime kontraktuale.


Kryesuesi, z. Rrahman Jakupi: Besoj që të gjitha diskutimet janë përmbyllur, tash është momenti për të votuar. Konstatoj kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Shtimes me 14 vota "Për", me 2 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", miratoi Vendimin për ndarjen e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2025 në vitin 2026.

Kryesuesi, z. Rrahman Jakupi: Pasi që diskutime tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoi në ora 12:09h.

Procesmbajtëse

Sadbere Halili



v.v.

Kryesuesi i Kuvendit

Rrahman Jakupi

